



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja Nr. 28
Prishtinë, më 24.06.2009
Salla N-225 ora 10,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Haset Cakolli dhe Mark Krasniqi.

Munguan: Memli Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Në mbledhje morën pjesë Nehat Mustafa kryetar i Komisionit Shtetëror të Maturës dhe Mustafe Kadriu, udheheqës i Divizionit për Standarde, Vleresim dhe Monitorim.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i UNDP-së, OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Informatë gjithëpërfshirëse e Kryetarit të Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës lidhur me rrjedhën e provimit të maturës shtetërore 2009.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes. Në vazhdim tha se Komisioni ka marrë qëndrim që lidhur me procesin dhe ecurinë e testit të maturës shtetërore të ftojë kryetarin e Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës me qëllim të informimit gjithpërfshirës për këtë çështje.

Nehat Mustafa, kryetar i Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës fillimisht e njoftoi Komisionin me të dhënat e fundit të procesit të maturës shtetërore të realizuar në qershor të këtij viti në komunat e Kosovës për të cilin proces është përgatitur një raport i cili i është dërguar edhe anëtarëve të Komisionit.

Në testin e maturës shtetërore këtë vit kanë marrë pjesë 25764 maturanë , nga të cilët 11656, ose 45,66 për qind kanë arritur sukses pozitiv, ndërsa 13937 e maturanëve nuk kanë arritur sukses pozitiv.

Mustafa tha se testi është realizuar në 29 komuna të Kosovës , ndërkaq 98 qendrat e testimit të vendit i kanë administruar dhe vëzhguar 3400 administratorë dhe vëzhgues, 320 anëtarë të komisioneve të qendrave të testimit, 100 monitorues nga UP- ja dhe 30 monitorues nga Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës, kabineti i ministrit të Arsimit , drejtorë departamentesh dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës ka vendosur që në shkollën e mesme Adem Gllavica në Lipjan dhe në një klasë të shkollës së mesme të mësimin në gjuhën boshnjake Ali Hadri në Pejë të pezullohen rezultatet e testimit dhe përsëritet testi i maturës për shkak të disa parregullsive.

Kryetari i KQSHM Mustafa tha se disa administratorë ishin të dobët, por për të gjithë procesin e testimit do të bëhet një analizë e përgjithshme

Në vijim anëtarët e Komisionit parashtruan pyetjet dhe sugjerimet e tyre.

Adem Hajdaraj, kërkoi sqarim lidhur me ndryshimet e vogla apo gabimet që llogariten në numrin e pikëve të testit të maturës, për gjuhën e testit të paralelet boshnjake, si dhe lidhur me keqpërdorimet e mundshme gjatë afatit të kohës së testit në shkollat e mesme profesionale.

Heset Cakolli i shqetësuar nga përqindja e rezultatit prej 46 % të kalueshmërisë së testit të maturës shtetërore tha se provimit të maturës shtetërore duhet ti qasemi me seriozitet si shoqëri. Për të dalë nga kjo situatë duhet bërë një analizë në mënyrë që të gjenden faktorët që kanë ndikuar në këtë sukses të nxënësve.

Me tej përmendi faktin se në komunën e Ferizajt sukseasi i testit të maturës shtetërore është 17 % më i ulët se vitin e kaluar, si dhe sukseasi i nxënësve të shkëlqyeshëm në testin e maturës ka qenë më i ulët në krahasim me nxënësit më të dobët të cilët kanë arritur rezultate më të favorshme.

Arsim Rexhepi tha se rezultatet e dhëna të provimit të maturës shtetërore nuk janë të kënaqshme dhe kërkoi që të analizohen arsyet e këtyre rezultateve. Ai përmendi informacionet e dhëna në mjetet e informimit për disa komuna si Skenderaj, Vushtrri Lipjan. Në komunën e Skenderajt del se rezultatet e dhëna nuk kanë qenë reale duke marrë parasysh përqindjen e kalueshmërisë prej 78% me këtë rast kërkoi nga kryetari i Komisionit shtetëror të maturës që të jap sqarime lidhur me mënyrën e organizimit dhe standardizimin e pyetjeve të testit të maturës shtetërore.

Enis Kervan tha se në bashkëpunim më të madh në të ardhmen do të zgjidhen problemet në suksesin e testit të maturës shtetërore. Ai përmendi faktin se nga mësimi në gjuhën turke dhe boshnjake rezultati i testit të maturës shtetërore ka qenë më i dobët se vitin e kaluar nga fakti se ende mungojnë tekstet në gjuhën turke dhe boshnjake.

Më tej kërkoi sqarim a ekzistojnë anëtarë të komunitetit turk në Komisionin Shtetëror të Maturës. Sa i përket doracakëve të cilët janë shpërndarë lidhur me provimin e maturës shtetërore ato kanë munguar në gjuhën turke dhe kërkon që të njëjtat të përkthehen edhe në gjuhën turke.

Mark Krasniqi tha se arsimi është një çështje me rëndësi që duhet ti kushtohet kujdes i veçantë. Për të dalë nga kjo situatë përmendi faktin se në të ardhmen duhet organizuar trajnime dhe seminare për arsimtarët në mënyrë që edhe ata të fitojnë njohuri të reja.

Donika Kadaj - Bujupi vlerëson se sukcesi dhe niveli i dobët i nxënësve është përgjegjësi e të gjithëve. Ajo tha se aspektet teknike për të cilat u diskutua si dhe pasqyra reale e suksesit të prezantuar janë shqetësuese. Lidhur me këtë kërkoi sqarim nga kryetari i KQSHM për rritjen e përqindjes së suksesit të testit të maturës në Komunën e Skenderajt si dhe të Ferizajt. Ajo tha se nëse rritja e suksesit në Komunën e Skenderajt është 100% më e madhe, atëherë cila është formula e këtij sukcesi, që në mënyrë që kjo formulë dhe ky sukses të merret si shembull për komunat e tjera të Kosovës për afatin e muajit gusht.

Gani Buçinca mendon se gjendja aktuale në arsim në përgjithësi është ndikuar edhe nga etnocidi kulturor gjë që është reflektuar edhe në shoqëri dhe në arsim.

Sa i përket infrastrukturës arsimore mendon se terminologjia e testeve të maturës është e paqartë dhe në këtë rast nuk respektohet parimi sistematik i njohurisë në aspektin e asaj se a ishin ato të përshtatshme si pyetje për maturanët.

Ne si shtet i ri duhet ti marrim si shembuj testet e maturës nga vendet me përvojë në këtë lëmi si të merren shembuj nga Shqipëria..

Nga MASHT kërkon që të publikojë një revistë apo katalog të cilin me të cilin do të shërbehen shkollat dhe në të cilin të jenë të përfshira njohuritë elementare dhe që nxënësit gjatë dy muajve të fundit të shkollimit të përgatiten me lëndët e provimit të maturës.

Drita Kadriu tha se çështja që po debatohet është brengosëse dhe në këtë aspekt shtroi dy çështje të procesit të maturës shtetërore.

Çështja e cilësisë së mësimdhënies në raport me standardet, tekstet shkollore dhe kurrikulet sa janë të angazhuar mësimdhënësit në këto teste, dhe çështjen tjetër nivelin e ulët të rezultateve në shkollat profesionale.

Ajo tha se ky proces duhet të jetë i hapur në mënyrë që të merremi konkretisht me këtë çështje.

Heset Cakolli kërkoi sqarim lidhur me nxënësit të cilët gjatë dy afateve të testit të maturës shtetërore nuk kanë kaluar pragun e kalueshmërisë dhe të cilët edhe këtë vit shkollor nuk kanë mundur të bëjnë këtë.

Agim Veliu, kryetar tha se Raporti i marrë nga MASHT nuk është analizuar sa duhet nga Komisioni dhe se kjo informatë nuk është gjithëpërfshirëse.

Nga kryetari i KQSHM kërkon sqarim për rezultatet e testit të maturës për shkollat profesionale që është rreth 31% të nxënësve.

Pyetje tjetër është numri i maturantëve që janë paraqitur për testin e maturës dhe sa është numri i nxënësve që kanë hyrë në këtë provim duke pasur parasysh faktin se një numër i nxënësve nuk ka hy në test.

Çështje tjetër është harmonizimi i testeve me plan programet mësimore, nëse këto teste janë të harmonizuara atëherë duhet gjetur shkakun e këtij sukse si të dobët të nxënësve. Në fund shtroi çështjen e zgjedhjes së kryetarit të Komisionit Shtetëror të Maturës nga ministri i arsimit, duke pasur parasysh faktin se kryetari i këtij Komisioni është këshilltar i ministrit të arsimit.

KQSHM ende nuk i ka analizuar të gjitha rrethanat të cilat e kanë sjellë këtë rezultat Komisioni do të dalë me konkluzione pas marrjes së informacionit të plotë nga KQSHM.

Nehat Mustafa kryetar i KQSHM në vazhdim u përgjigj pyetjeve të anëtarëve të Komisionit.

Sa i përket pyetjes së zgjedhjes së tij në këtë post ai tha se në Ligjin për Maturën Shtetërore nuk përcaktohet se kush nuk mund të jetë kryetar i KQSHM.

Mustafa tha se paraqitja e rezultatve është reale dhe se testi ka qenë i standardizuar dhe harmonizuar me planprogramet dhe tekstet shkollore të hartuara nga MASHT .

Sistemi i ndërtimit të pyetjeve është bërë nga ekspertët e çdo lëmie, dhe nga prononcimet e para të maturantëve testi nuk ka qenë i rëndë.

Ne si Komision jemi të obliguar që ti hulumtojmë rastet, në këtë rast në komunën e Skenderajt kemi kërkuar informata shtesë nga anëtarët e KQSHM dhe administratorët.

KQSHM nuk ka gjetur fakte bindëse që do ta anulonin testin ndërsa nëse gjendet ndonjë fakt testi do të anulohet.

Sa i përket komunës së Ferizajt këtë vit përqindja e kalueshmërisë së testit është 46% në krahasim me vitin e kaluar që ka qenë 45% , ndërsa vitin e kaluar pragu i kalueshmërisë është ulur nga 50 në 45% me vendim të ministrit të arsimit.

Sa i përket trajnimeve planifikojmë që me Udhëzim Administrativ vitin e ardhshëm të organizojmë trajnime dhe do të ketë edhe katalogë për trajnim të mësimdhënësve dhe në këtë aspekt presim edhe ndihmën nga ekspertët ndërkombëtar.

Sa i përket mënyrës së kontrollimit të testeve kjo është transparente të gjitha testet mbeten për gjashtë muaj në njësinë për standardizim dhe mënyra e kontrollimit të testeve është e evidente.

Komisioni ka marrë qëndrim që në këtë vit shkollor të mos zbritet kriteri i kalueshmërisë sikurse ka ndodhur vitin e kaluar.

Anëtarët e Komisionit shtruan domosdoshmërinë që të bëhet një analizë e faktorëve që ndikuan në një rezultat të këtillë jo të kënaqshëm, por edhe për dobësitë që u shfaqën gjatë testimit.

Kryetari i Komisionit tha se pas marrjes së informatës dhe Raportit të analizuar dhe gjithpërfshirës nga KQSHM, Komisioni do të hartojë një rekomandim lidhur me testin e maturës shtetërore.

Komisioni do të shqyrtojë dhe monitorojë zbatimin e Ligjit të Maturës Shtetërore dhe do ti analizojë mangësitë eventuale të këtij Ligji.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11, 55

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu